

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	100 mijë shqiptarë - FOTO/
ADRESA	https://www.syri.net/kosova/916227/foto-marshi-per-liri-mbush-sheshet-ne-prishtine-ne-prag-te-verdiktit-te-gjykates-speciale/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 18:34:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 18:13:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d3af28282fd0ddd5f3ae509c1815593fdc4e505259ca77e507472c798b246164
TEKSTI	de8c73b7716c07d25f0bbd65b8222e539089c77e534828093cc4d5f134fc066d
PAMJA	48d6495dd7111b5ae992044708a7df861e70ccc0d40bda4fbd8bd627cd2b70f1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d47da9b4173d458a4b535859d1a875a32afe86deded6d7a76ac5bde2f9d6db71
E MËPARSHMJA	7210976ad6e7c1f1f793628c28a9da1085c9a1d2239eb2b644927b5d80d7d8ba
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d47da9b4173d458a4b535859d1a875a32afe86deded6d7a76ac5bde2f9d6db71>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkençë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Op-Ed](#)
 - [Analizë](#)
 - [Blog](#)
- [P.L.U.G](#)

toggle menu

 [Ilir Kalemaj](#) [Ilir Kalemaj](#) [Dokrra hini dhe bota në tranzicion](#)

 [Enver Bytyçi](#) [Enver Bytyçi](#) [Edi Rama edhe në varr nuk ndahet nga Aleksandër Vuçiq!](#)

 [FOTO/ 'Marshi për Liri'](#) mbush sheshet në Prishtinë në prag të verdiktit të Gjykatës Speciale

-
-
-
-

FOTO/ 'Marshi për Liri' mbush sheshet në Prishtinë në prag të verdiktit të Gjykatës Speciale

20:13, 12/09/2026

Në Prishtinë sot u zhvillua "Marshi për Liri" në mbështetje të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po gjykohej në Hagë, vetëm katër ditë para shpalljes së aktgjykimit përfundimtar në rastin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Platforma qytetare "Liria ka Emër" ka thënë se në "Marshin për Liri" kanë marrë pjesë rreth 100 mijë qytetarë.

Një skenë ku u mbajtën fjalime dhe performanca ishte ngritur në sheshin Skënderbeu, i cili ishte mbushur me njerëz, ngjashëm si rrugët që çojnë drejt tij, si sheshi Nëna Terezë dhe Zahir Pajaziti.

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të partive politike, veteranë të luftës në Kosovë, dhe familjarë të të akuzuarve dhe të dëshmorëve të luftës.

Gjatë fjalimit, kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, tha se veteranët dhe familjet e tyre kërkojnë një proces të drejtë dhe të paanshëm.

Ai tha se një "proces i padrejtë" do t'i shërbente vetëm Serbisë dhe Rusisë.

Emblemat e UÇK-së ngjyrosin Prishtinën kuqezi në "Marshin për Liri"

"Liria e Kosovës u fitua me mund e sakrificë. Asnjë sallë e gjyqit nuk mund ta fshijë këtë të vërtetë", tha ai.

Ndërsa, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, tha se vendimi i 16 shtatorit nuk do të pranohet nëse është "i padrejtë".

"Prandaj atyre që marrin vendimet, nga ky shesh u themi 'mendon për pasojat para se të vendosni më 16 shtator'", tha Hamza.

Para tij, kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, tha se katër ish-krerët e UÇK-së kishin luftuar për lirinë e Kosovës dhe se tani ka ardhur koha që atyre t'u shprehej mirënjohje.

"Kush kurrë nuk do të arrijë ta ndotë tregimin tonë për liri", tha ai.

Pas përfundimit të marshit, përmes një komunikate për media, edhe Qeveria e Kosovës falenderoi organizatorët e marshit dhe pjesëmarrësit për mesazhin e dërguar.

Marshi, i organizuar nga lëvizja qytetare "Liria ka Emër", zhvillohet në një periudhë kur procesi gjyqësor ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së ka hyrë në fazën përfundimtare. Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë caktuar 16 shtatorin si datën e shpalljes së aktgjykimit, pas më shumë se tre vjetësh nga nisja e gjyqimit, shkruan REL.

Katër të akuzuarit përballen me akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ata i kanë mohuar të gjitha akuzat.

Protesta e sotme nuk është e para që organizohet në Kosovë kundër Gjykatës Speciale apo në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së.

Në prill të vitit 2023, një ditë para nisjes së gjyqimit ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, mijëra qytetarë marshuan në Prishtinë në mbështetje të tyre. Protestuesit e cilësuan procesin si të padrejtë dhe shprehën përkrahje për luftën e UÇK-së.

Një prej tubimeve më të mëdha të viteve të fundit u mbajt më 17 shkurt 2026, në 18-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. Mijëra qytetarë morën pjesë në marshin "Drejtësi, jo politikë", të organizuar në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së.

Ky marsh u mbajt në kohën kur gjykimi në Hagë po i afrohej fundit. Prokuroria kishte përfunduar paraqitjen e rastit në prill 2025, mbrojtja e kishte përfunduar rastin në dhjetor të po atij viti, ndërsa deklaratat përmbyllëse u mbajtën në shkurt 2026.

Pas kësaj, shpallja e aktgjykimit u shty. Fillimisht ishte paraparë për më herët gjatë vitit, ndërsa në korrik Dhomat e Specializuara njoftuan se verdikti do të shpallet më 16 shtator, duke e arsyetuar shtyrjen me kompleksitetin e rastit dhe vëllimin e madh të provave.

Në këtë rast, prokuroria pretendon se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi mbajnë përgjegjësi penale për krime të kryera në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë gjatë periudhës së luftës.

Aktakuza përfshin gjashtë pika për krime kundër njerëzimit dhe katër për krime lufte dhe Prokuroria ka kërkuar nga 45 vjet burgim për secilin të akuzuar.

Të katër ish-krerët e UÇK-së u arrestuan në nëntor 2020 dhe u transferuan në qendrën e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë. Gjykimi nisi më 3 prill 2023.

Aktgjykimi i 16 shtatorit pritet të jetë një prej vendimeve më të rëndësishme të Dhomave të Specializuara, të krijuara në vitin 2015 për gjykimin e rasteve që lidhen me pretendime për krime të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së gjatë dhe pas luftës së viteve 1998-1999.

- 
- 
- 
- 
- 



Marshi në mbështetje të ish-udhëheqësve të UÇK-së, foto Driton Paçarada, koha.net

© SYRI.net

Lexo edhe:

-  [Vajza e Sali Mustafës: Drejtësia s'mund t'i barazojë çlirimtarët me xhelatët serbë](#)
-  [Hamza për gjyqtarët e Hagës: Mendoni pasojat! Vendimi i padrejtë do ishte dënim për Kosovën! Kur preket UÇK-ja, ne ringrihem](#)
-  ['Liria ka Emër!'/ Në marshim morën pjesë rreth 100 mijë qytetarë](#)

Komentet

Shto koment

Posto

Më të lexuarat
[Kosova](#)

[FOTO/ 'Marshi për Liri' mbush sheshet në Prishtinë në prag të verdiktit të Gjykatës Speciale](#)

[Kosova](#)

[Pengimi i drejtësisë/ Prokuroria në Hagë kërkon 6 vjet burgim për Hashim Thaçin](#)

[Kosova](#)

[Haxhiu shtyn për të dielën seancën konstituive mes mosmarrëveshjeve për nënkryetarët](#)

[Kosova](#)

[Kurti: Të konstituohet Kuvendi dhe të shmangen zgjedhjet e reja](#)

[Kosova](#)

[A mund Haxhiu ta ushtrojë detyrën e presidentit edhe për gjashtë muaj të tjerë?](#)

[Sport](#)

[E rëndë/ Sulmohet dhe kërcënohet kapiteni i Kosovës Amir Rrahmani, denoncohen rastet](#)

[Kosova](#)

[Kurti: Emrat për nënkryetarët duhet të sqarohen në takime të përbashkëta](#)

[Kosova](#)

[Mbrojtja: Nuk ka prova që Thaçi ka ndërhyrë te dëshmitarët](#)

[Kosova](#)

[‘Politika është larguar nga njerëzit’, Andoni: Kanë prishur mitin e zgjedhjeve të lira](#)

[Kosova](#)

[Gjykata e Apelit liron nga akuzat Çekun dhe 9 të dënuarit e tjerë në rastin 'Veteranët'](#)

TË NGJASHME

[Kosova](#)

[Waters: Teoria që lidh Thaçin dhe të tjerët me krime mund të shtrihet shumë gjerë](#)

[Kosova](#)

[Profesori amerikan: Teoria që lidh Thaçin dhe të tjerët me krime mund të shtrihet shumë më gjerë](#)

[Sport](#)

[Amir Rrahmani njofton largimin nga Kosova: Nuk do të jem më pjesë për sa kohë drejtohet nga këta persona](#)

[Kosova](#)

[Si një virus lidh Gjermaninë dhe Kosovën](#)

[Kosova](#)

[Kosovë/ Qeveria nderon viktimat e 11 Shtatorit, ndërtesa ndriçohet me flamurin amerikan](#)

[Kosova](#)

[Gjykata e Apelit liron nga akuzat Çekun dhe 9 të dënuarit e tjerë në rastin 'Veteranët'](#)

- [Lajme](#)
 - [Web TV](#)
 - [Kuriozitete](#)
 - [Arte & media](#)
 - [Sociale](#)
 - [English](#)
 - [Shëndet](#)
 - [Tjera](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kosova](#)
- [Botë](#)
 - [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Shkencë](#)
 - [Teknologji](#)
- [Sport](#)
 - [Botërori 2026](#)
- [Jetë/stil](#)
- [Trashëgimi](#)
 - [Histori](#)
- [Mjedis](#)
 - [Klimë](#)
- [Arkiva](#)

SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendeni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

[Denonco](#)

Mermi lajmet më të fundit nga SYRI.net në çdo moment dhe kudo që të jeni!

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.